VENDIM
Nr. 65/2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 47/2013 "PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 47/2013, "Për caktimin e përbërjes së sekretariateve të Kuvendit", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Florion Mima (PD) caktohet sekretar i Sekretariatit për Buxhetin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Edmond Spaho

Miratuar në datën 22.9.2016